



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 5, datë 23.01.2014**

**PËR  
LICENCIMIN E SHOQËRISË “IFIS BROKER” SH.A., SI SHOQËRI BROKERIMI NË  
SIGURIME DHE LICENCIMIN E Z. SOTIRAQ GUGA SI BROKER FIZIK NË  
SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/dh, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 81, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe VKM-së nr. 79, datë 28.01.2008, “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës”, me propozim të Departamentit të Licencimit e Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

1. Licencimin e shoqërisë “IFIS Broker” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë së brokerit në sigurime për klasat e Jo-Jetës, Jetës dhe risigurime me afat të pacaktuar.
2. Licencimin e Z. Sotiraq Guga, si broker fizik në sigurime për klasat e Jo-Jetës, Jetës dhe risigurime, me afat 3 vjeçar, në emër dhe për llogari të shoqërisë “IFIS Broker” sh.a.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Enkeleda SHEHI**